# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-426375**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Shqipëria përballet me 11 vatra aktive zjarri, situata problematike në Malin e Dajtit |
| ADRESA | `https://indeksonline.net/shqiperia-perballet-me-11-vatra-aktive-zjarri-situata-problematike-ne-malin-e-dajtit/` |
| BURIMI | indeksonline.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 07:19:54 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 6 shtator 2026, 22:00:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 6 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 6 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e6967c263cf49d2bae173d1bbea3fe27332844388924daf33d1fdc8764e1a227` |
| TEKSTI | `b3a69ecfb9e53426f75f18b50d462b7a8cadaff2d2e1135c94a0c42df6c62350` |
| PAMJA | `dfe16931e688a5d54a17184e31f6eb1cacf45a0ae2418282f51eca7e1b6d05ef` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `56b5d177b3db3248f3f439cef6c594dab27fe7c13e0edc296a00cb32ff8655d9` |
| E MËPARSHMJA | `3599bd0767b3166a61ad4cb69dd2ae0b6a286e3eee85b32a4dadf3f19d94ee1d` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/56b5d177b3db3248f3f439cef6c594dab27fe7c13e0edc296a00cb32ff8655d9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

09:18 / E Hënë, 07 Shtator 2026 / S Z

# Shqipëria përballet me 11 vatra aktive zjarri, situata problematike në Malin e Dajtit

Shqipëria po përballet me 11 vatra aktive zjarri, ndërsa situata më problematike paraqitet në Malin e Dajtit.

Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë ka bërë të ditur se gjatë 6 shtatorit, deri në orën 20:00, janë raportuar gjithsej 20 vatra. Prej tyre, 11 mbeten aktive, shtatë janë nën mbikëqyrje, ndërsa dy janë shuar, transmeton KosovaPressi.

Në operacionet për përballimin e situatës janë angazhuar strukturat vendore dhe forcat e armatosura, me kapacitete tokësore dhe ajrore.

Vëmendja kryesore mbetet në Malin e Dajtit, ku flakët vazhdojnë të jenë aktive. Në ndërhyrje po marrin pjesë edhe forcat e armatosura me efektivë, mjete dhe helikopter.

Situatë problematike paraqitet edhe në Kryezi të Kavajës. Krahas forcave zjarrfikëse, në këtë zonë është angazhuar edhe një avion “Air Tractor”.

Zjarre aktive janë raportuar gjithashtu në Dibër, veçanërisht në zonën Lundre–Madhesh të Matit. Në Lezhë po vazhdon ndërhyrja në Kalivaç–Zimaj–Kashnjet, me mbështetjen e dy helikopterëve të forcave të armatosura.

Në Qarkun e Shkodrës, vatra Bardhaj–Myselim mbetet aktive. Në operacion janë përfshirë strukturat vendore, vullnetarët dhe forcat e armatosura, përfshirë dy helikopterë. Flakët vazhdojnë edhe në Kulumri të Fushë-Arrëzit.

Vatra aktive janë regjistruar edhe në Kropisht të Selenicës dhe Vokopolë të Poliçanit.

Ndërkohë, disa zjarre në Korçë, Elbasan, Durrës, Fier, Kukës dhe Shkodër janë nën mbikëqyrje. Situata në Drizë–Peshtan–Frakull të Fierit po ashtu po monitorohet.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile po e ndjek situatën në të gjithë territorin e Shqipërisë, në koordinim me prefekturat, bashkitë dhe strukturat e tjera përgjegjëse.

Kapacitetet operacionale mbeten në terren dhe në gatishmëri për ndërhyrje, me prioritet mbrojtjen e jetës së qytetarëve, banesave dhe pronës.

**Mos i humb**

- **Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet (Foto)**

- **“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë**

- **“I ke 30 minuta… Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman, që i dëboi nga Prizreni ushtarët serbë?**

- [Shoferi i dehur gjobitet 2 herë, brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie]

- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore]

- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'e përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur]

- [Aksident i rëndë në autostradën "Ibrahim Rugova", të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore]

Facebook Follow Instagram

TEL Redaksia: +383 (0) 48 36 36 39 | Marketing: +383 (0) 49 686 666 EMAIL info@indeksonline.net | marketing@indeksonline.net

[Indeksonline.net]

Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte veçse një kërkesë e kohës.

origjinale, në Kosovë, nder shqiptare dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte veçse një kërkesë e kohës.

Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.!!

© 2010 - 2026 Portali Indeksonline. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.